Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01/517
Datë: 21.08.2024

Në mbështetje të neneve 8, 9 dhe 16 të Ligjit Nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare, të Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr. 35/2014 për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, nenit 5 paragrafi 4, 5 dhe 6 si dhe nenit 6 paragrafi 1 të Rregullores Nr. 01/196 e punës e Këshillit Drejtues të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur me datë 12.08.2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. **Riakreditohet dhe Rivalidohet** Qendra e aftësimit profesional "International Beauty Brands" – Clarissa SH.P.K, me adresë: Rr. Nënë Tereza, Fushë Kosovë, për periudhën tre (3) vjeçare, përkatësisht nga data 01.12.2023 deri 30.11.2026, me kualifikimin e aprovuar në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (KKK):

1. **Manikyr**, Niveli III i KKK, lloji: Kualifikimet kombëtare profesionale (D) me 5 kredi të AAP. Institucioni mund të realizojë procesin e trajnimit me 10 grupe brenda vitit kalendarik me 12 kandidatë në grup, me një ndërrim në ditë. Numri maksimal i kandidatëve që mund të trajnohen brenda vitit kalendarik është 120 kandidatë.

II. Obligohet Institucioni që të plotësoj kushtet bazuar në vendimin e Këshillit Drejtues Nr.01/402 të datës 13.06.2024.

III. Obligohet AKK të bëjë monitorimin e përmbushjes së këtyre kushteve.

IV. Institucioni mban përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim apo tejkalim të këtij vendimi.

V. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

ARSYETIM

Institucioni "International Beauty Brands" – Clarissa SH.P.K, me datë 30.06.2023 ka parashtruar në AKK kërkesë për riakreditim dhe rivalidim të institucionit për kualifikimin:

- *Manikyr, niveli III i KKK dhe e cila në AKK është protokolluar dhe ka marrë numër 01/372.*

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve bazuar në dispozitat ligjore në fuqi nga fushëveprimtaria e AKK-së ka caktuar ekipet e eksperteve të jashtëm me qëllim të vlerësimit të institucionit lidhur me përmbushjen e kritereve për riakreditim dhe rivalidim për kualifikimet si më lartë.

Ekipet e ekspertëve pas shqyrtimit të dosjes së aplikimit, me datë 28.05.2024 kanë realizuar vizitën në institucionin "International Beauty Brands" – Clarissa SH.P.K, ndërsa pas përfundimit të procesit vlerësues, me datë 07.06.2024 kanë përpiluar raportet vlerësuese përfundimtare për riakreditim dhe rivalidim për kualifikimin për të cilin institucioni ka parashtruar kërkesë bazuar në analizimin e dosjes së aplikimit dhe të gjeturat me rastin e realizimit të vizitës.

Raportet vlerësuese të ekipit të ekspertëve janë proceduar për vendimmarrje në mbledhjen e Këshillit Drejtues të datës 12.08.2024.

Rekomandimet përfundimtare të ekipeve të ekspertëve janë mbështetur në dëshmi dhe dokumente të ofruara nga institucioni në fazën e aplikimit si: aplikacionet për rivalidim të kualifikimit, aplikacionit për riakreditim të institucionit, raportin e vetëvlerësimit të dorëzuar nga institucioni si dhe të gjeturave me rastin e realizimit të vizitës së realizuar tek pala aplikuese.

Këshilli Drejtues i AKK-së me qëllim të zbatimit të drejtë të Udhëzimit Administrativ MASHT Nr. 35/2014 Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë ka nxjerr vendimin Nr.01/402 të datës 13.06.2024, sipas të cilit janë të përcaktuara kriteret që Institucionet e Arsimit dhe Aftësimit Profesional duhet ti përmbushin në afat kohor 3 deri 6 muaj. Ndërsa AKK bazuar në nenin 18 të Ligjit Nr/ 03/L-060 Për Kualifikimet Kombëtare dhe nenin 23 të Udhëzimit Administrativ MASHT Nr. 35/2014 Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Republikën e Kosovës, është e obliguar të realizoj procesin e monitorimit dhe të raportoj tek Këshilli Drejtues i AKK-së.

Andaj, Këshilli Drejtues i AKK-së në bazë të kërkesës së Institucionit "International Beauty Brands" – Clarissa SH.P.K, për riakreditim dhe rivalidim, rekomandimeve përfundimtare të ekipeve të ekspertëve të dhëna në raportet vlerësuese për riakreditim dhe rivalidim për institucionin aplikues, kompetenca si dhe dispozitave ligjore të lartcekurat, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pikat 1, 2, 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ të MASHT për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me Nr. 35/2014. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet KD të AKK-së, në afat prej 15 ditësh pas lëshimit të vendimit.*

Vendimi u dërgohet:

1. Institucionit "International Beauty Brands" – Clarissa SH.P.K,
2. Arkivit të AKK-së.

Valmira Sejdiu

Zv.Kryetar i KD të AKK-së